



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1067/ 4 prot

Datë 15/06/2026

V E N D I M
Nr. 801/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/06/2026, me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Klame” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetëmilion e katërqindenëntëdhjetekatërmijë e një), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Modifikimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Klame” SHPK me NIPT K21518003F dhe adresë: *Njësia Administrative 11, Kodër-Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë
Adresa: Pranë Stadiumit, Himarë .

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.03.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetëmilion e katërqindenëntëdhjetekatërmijë e një), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

II.2. Në datën 07.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/1067, datë 07.04.2026, dhe me nr. 1067/2026 prot, datë 08.04.2026, e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt,

numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datë 15.04.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 362/13 prot, datë 14.04.2026 “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1067/1 prot, datë 15.04.2026, ku ka dërguar vendimin nr. 362/12 prot, datë 14.04.2026 “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së OE “KLAME” SHPK” të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK, nga ku rezulton se ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik mbi kriterin për personelin (shoferët), konkretisht kërkesën për 2 (dy) shoferë, vlerësoj se ky kriter është vendosur me qëllim garantimin e realizimit në kohë dhe në mënyrë të sigurt të transportit të mallrave objekt prokurimi. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe i kërkesave të tjera teknike, rezulton se është parashikuar disponimi i vetëm 1 (një) mjeti transporti, çka tregon se kërkesa për 2 (dy) shoferë nuk është në raport të drejtë me nevojat reale të kontratës. Në mungesë të një argumentimi të qartë teknik ose operacional që do të justifikonte nevojën për më shumë se një shofer për një mjet të vetëm, çmoj se ky kriter krijon një barrë të panevoshme për operatorët ekonomikë dhe mund të kufizojë pjesëmarrjen në procedurë, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës së lirë. Duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, vëllimin e furnizimit dhe organizimin e zakonshëm të shërbimit të transportit, vlerësoj se kërkesa për 1 (një) shofer ishte e mjaftueshme për përmbushjen e kontratës në mënyrë efektive dhe të sigurt, duke garantuar njëkohësisht një balancë të drejtë ndërmjet kërkesave të autoritetit kontraktor dhe mundësive reale të operatorëve ekonomikë.

Për rrjedhojë, vendosa pranimin e pretendimit të operatorit ekonomik, duke modifikuar kriterin përkatës dhe duke përcaktuar kërkesën për 1 (një) shofer, në përputhje me numrin e mjeteve të kërkuara dhe nevojat konkrete të realizimit të kontratës. [...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si në vijim: “... Kundërshtojmë kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.3 në lidhje me kërkesën për personelin: 2 (dy) shoferë si kriter të pajustificuar, joproporcional dhe në kundërshtim me vetë kërkesat e tjera të vendosura nga autoriteti kontraktor.

...

Në këto kushte, kërkojmë ndryshimin e kriterit përkatës duke e përcaktuar si më poshtë: 1 (një) shofer.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Përmes shkresës me shkresën nr. 362/13 prot, datë 14.04.2026 “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1067/1 prot, datë 15.04.2026, ku ka dërguar vendimin nr. 362/12 prot, datë 14.04.2026 “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së OE “KLAME” SHPK” të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK, nga ku rezulton se ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë vijon::

[...] Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik mbi kriterin për personelin (shoferët), konkretisht kërkesën për 2 (dy) shoferë, vlerësoj se ky kriter është vendosur me qëllim garantimin e realizimit në kohë dhe në mënyrë të sigurt të transportit të mallrave objekt prokurimi. Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe i kërkesave të tjera teknike, rezulton se është parashikuar disponimi i vetëm 1 (një) mjeti transporti, çka tregon se kërkesa për 2 (dy) shoferë nuk është në raport të drejtë me nevojat reale të kontratës. Në mungesë të një argumentimi të qartë teknik ose operacional që do të justifikonte nevojën për më shumë se një shofer për një mjet të vetëm, çmoj se ky kriter krijon një barrë të panevoshme për operatorët ekonomikë dhe mund të kufizojë pjesëmarrjen në procedurë, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës së lirë. Duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, vëllimin e furnizimit dhe organizimin e zakonshëm të shërbimit të transportit, vlerësoj se kërkesa për 1 (një) shofer ishte e mjaftueshme për përmbushjen e kontratës në mënyrë efektive dhe të sigurt, duke garantuar njëkohësisht një balancë të drejtë ndërmjet kërkesave të autoritetit kontraktor dhe mundësive reale të operatorëve ekonomikë.

Për rrjedhojë, vendosa pranimin e pretendimit të operatorit ekonomik, duke modifikuar kriterin përkatës dhe duke përcaktuar kërkesën për 1 (një) shofer, në përputhje me numrin e mjeteve të kërkuara dhe nevojat konkrete të realizimit të kontratës. [...]

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”.

III.1.4. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimesit për modifikimin e afatit të zbatimit të kontratës objekt prokurimit të përcaktuar në pikën 2.11 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës” të Seksionit 2 “Objekti i kontratës”, si dhe në Shtojcën 7 “FORMULARI I I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si në vijim: “...Në Dokumentet Standarde të Tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar si afat për realizimin e kontratës 20 (njëzet) ditë nga data e nënshkrimit të saj. Ky afat rezulton jorealist, joproporcional dhe kufizues i konkurrencës, pasi nuk merr në konsideratë natyrën konkrete të objektit të prokurimit dhe proceset e domosdoshme për realizimin e tij. Në mënyrë të veçantë, furnizimi me mallrat objekt prokurimi kërkon procese të tilla si porositja pranë prodhuesit, prodhimi sipas specifikimeve teknike dhe transporti ndërkombëtar, të cilat, në praktikën normale të tregut, kërkojnë një periudhë minimale prej 23 muajsh. Vendosja e një afati prej vetëm 20 ditësh për realizimin e kontratës krijon një avantazh të padrejtë për operatorë të caktuar dhe përjashton në mënyrë të pajustificuar operatorët e tjerë ekonomikë që operojnë në kushte normale tregu. Për rrjedhojë, ky afat bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës efektive, të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik. Në këto kushte, kërkojmë ndryshimin e këtij afati duke e përcaktuar në një periudhë minimale prej të paktën 3 (tre) muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në pikën 2.11 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës” të Seksionit 2 “Objekti i kontratës” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar afatin e realizimit të kontratës objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj □□□ ose ditë **20 (njëzetë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.**
 Sipas nevojave të Autoriteteve Kontraktore Përfituese, nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktor, në bazë të marrëveshjeve kuadër.
 Ose
 Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

III.2.2. Gjithashtu në Shtojcën 7 “**FORMULARI I I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi,, autoriteti kontraktor ka përcaktuar afatin e realizimit të kontratës objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emërtimi i produktit	Njësia	Sasia
1	Tavolinë mësuesi cikli i lartë, arsimit i mesëm	copë	20
2	Dërrasë e zezë 180x 120 cm	copë	40
3	Tabelë druri për të varur shënimet (e mbyllur)	copë	5
4	Varëse rrobash e fiksuar në mur	copë	15
5	Karrige të thjeshta zyre	copë	70
6	Varëse rrobash	copë	16
7	Tavolinë pune e thjeshtë	copë	25
8	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse	copë	6
9	Komplet perde	komplet	1
10	Bank dyshe e çmontueshme	copë	100
11	Bank teke e çmontueshme	copë	50
12	Karrige nxënësi cikël i ulët	copë	80
13	Karrige nxënësi cikël i lartë	copë	200
14	Dollap metalik me dyer	copë	20
15	Raft për bibliotekën	copë	20
16	Mbajtëse lodrash / mjetesh	copë	20
17	Karrige kopshti me tapiceri	copë	130
18	Tavolinë kopshti drejtkëndore	copë	30
19	Klasifikator metalik me tre sirtarë	copë	6
20	Raft metalik për dosje (arshivë)	copë	2

21	Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik	copë	15
22	Sirtariere metalike	copë	2
23	Mobilje për kuzhinë	copë	1
24	Perde roller	m ²	70
25	Pod / Pedanë për sallë mbledhjesh m2	copë	50
26	Karrige statike pa krahë mbështetës	copë	40
27	Tavolinë podium	copë	1
28	Karrige auditori	copë	4
29	Tavolinë referimi salle	copë	1
30	Sirtarierë e lëvizshme me rrota	copë	1
31	Sistem arkivimi me shina dhe doreza rrotulluese që lëvizin raftet	copë	2
32	Rafte metalike statike për dokumente	copë	1
33	Rafte metalike për (bibliotek)	copë	4

Afatet e lëvrimit: 20 (njëzetë) ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës së furnizimit.

III.2.3. Autoriteti kontraktor me shkresën nr. 362/13 prot, datë 14.04.2026 “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1067/1 prot, datë 15.04.2026, ku ka dërguar vendimin nr. 362/12 prot, datë 14.04.2026 “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së OE “KLAME” SHPK” të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK, nuk e ka pranuar këtë pretendim të ankimuesit, duke argumentuar si në vijim: “Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik se afati prej 20 (njëzetë) ditësh është i pamjaftueshem dhe joproporcional, vlerësoj se ky afat është përcaktuar, duke marrë në konsideratë nevojën për furnizim të shpejtë. Megjithatë, me qëllini garantimin e një pjesëmarrjeje sa më të gjërë të operatorëve ekonomike, çmoj se ky afat mund të rezultojë kufizues për operatorët që nuk disponojnë stok të menjëhershëm, por e realizojnë furnizimin përmes prodhimit ose porosive specifike. Duke pasur parasysh praktikën e tregut, si dhe kohën e nevojshme për prodhim, furnizim dhe transport, vlerësoj të arsyeshme rishikimin e afatit të realizimit të kontratës, me synim sigurimin e një konkurrimi më efektiv dhe proporcional. Sa i përket kërkesës për zgjatjen e këtij afati në 60-90 ditë, vlerësoj se një periudhë e tillë është përtej nevojave reale të autoritetit kontraktor dhe nuk qëndron në raport të drejtë me natyrën e mallrave dhe urgjencën për furnizim.

Në këtë kuadër, duke balancuar nevojën për furnizim në kohë me mundeësinë reale të operatorëve për të përmbushur kontratën, vlerësoj se një afat prej 30 (tridhjetë) ditësh përbën një zgjidhje të arsyeshme dhe proporcionale. Për rrjedhojë, vendosa pranimin pjesërisht të pretendimit të ankuesit, duke rishikuar afatin e realizimit të kontratës në 30 (tridhjetë) ditë, në përputhje me natyrën e mallrave dhe kushtet e tregut.”.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar thuhet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.6. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 1 të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe 7 mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës

për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.8. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit që lëvrimi i mallit do të bëhet *“20 (njëzetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës”*, ku operatori ekonomik ankimues *“KLAME” SHPK* ka pretenduar se ky afat dyhet të modifikohet në të paktën 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës, ndërkohë që Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar këtë pretendim të ankimuesit, duke e modifikuar afatin e zbatimit të kontratës në 30 (tirdhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës;

Lidhur me pretendimin e ankimuesit, Komisioni gjykon se ky afat lëvrimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t’ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objektankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimit të mallit në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“KLAME” SHPK* qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për heqjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.9 *“Kapaciteti teknik”* të Shtojcës 8 *“FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”* të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si në vijim: *“...Për sa më sipër, kërkojmë heqjen e kërkesës për paraqitjen e mostrave, si një kërkesë kufizuese dhe jo në përputhje me parimet e konkurrencës dhe proporcionalitetit..”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.5 dhe në pikën 2.3.9 *“Kapaciteti teknik”* të Shtojcës 7 *“FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”* të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së prokurimit, mostër të produkteve si më poshtë:

- Bank dyshe e çmontueshme
- Bank teke e çmontueshme

- Dollap metalik me dyer
- Klasifikator metalik me tre sirtarë
- Karrige auditori

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: pranë stadiumit, Himarë. ”.

III.3.2. Në Shtojcën 7 “*FORMULARI I I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi,, autoriteti kontraktor ka përcaktuar afatin e realizimit të kontratës objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emërtimi i produktit	Njësia	Sasia
1	Tavolinë mësuesi cikli i lartë, arsimit i mesëm	copë	20
2	Dërrasë e zezë 180x 120 cm	copë	40
3	Tabelë druri për të varur shënimet (e mbyllur)	copë	5
4	Varëse rrobash e fiksuar në mur	copë	15
5	Karrige të thjeshta zyre	copë	70
6	Varëse rrobash	copë	16
7	Tavolinë pune e thjeshtë	copë	25
8	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse	copë	6
9	Komplet perde	komplet	1
10	Bank dyshe e çmontueshme	copë	100
11	Bank teke e çmontueshme	copë	50
12	Karrige nxënësi cikël i ulët	copë	80
13	Karrige nxënësi cikël i lartë	copë	200
14	Dollap metalik me dyer	copë	20
15	Raft për bibliotekën	copë	20
16	Mbajtese lodrash / mjetesh	copë	20
17	Karrige kopshti me tapiceri	copë	130
18	Tavolinë kopshti drejtkëndore	copë	30
19	Klasifikator metalik me tre sirtarë	copë	6
20	Raft metalik për dosje (arshivë)	copë	2

21	Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik	copë	15
22	Sirtariere metalike	copë	2
23	Mobilje për kuzhinë	copë	1
24	Perde roller	m ²	70
25	Pod / Pedanë për sallë mbledhjesh m2	copë	50
26	Karrige statike pa krahë mbështetës	copë	40
27	Tavolinë podium	copë	1
28	Karrige auditori	copë	4
29	Tavolinë referimi salle	copë	1
30	Sirtarierë e lëvizshme me rrota	copë	1
31	Sistem arkivimi me shina dhe doreza rrotulluese që lëvizin raftet	copë	2
32	Rafte metalike statike për dokumente	copë	1
33	Rafte metalike për (bibliotek)	copë	4

Afatet e lëvrimit: 20 (njëzetë) ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës së furnizimit.

III.3.3. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e kriterëve kualifikues të përcaktuara përkatësisht në pikën 2.3.5 dhe në pikën 2.3.9 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

“2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përpunje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë”.

Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të paraqesë katalogë, fragmente katalogu ose skeda teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën e autoritetit kontraktor për të verifikuar përputhshmërinë e mallrave të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në rastin e prokurimit të mobiljeve, vlerësimi i ofertës nuk mund të mbështetet vetëm në deklarime përshkruese, por kërkon evidenca konkrete dhe të verifikueshme mbi karakteristikat reale të produkteve.

Mobiljet, veçanërisht ato për përdorim institucional si në ambiente shkollore, duhet të plotësojnë një sërë parametrash teknike që lidhen me përmasat, materialet e përdorura, strukturën mbajtëse, rezistencën, përfundimin sipërfaqësor dhe sigurinë në përdorim. Këto elemente nuk mund të verifikohen në mënyrë objektive pa dokumentacion teknik shoqërues, si katalogët apo skedat teknike të prodhuesit, të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara dhe të standardizuara për secilin produkt.

Paraqitja e këtyre dokumenteve i mundëson autoritetit kontraktor të kryejë një vlerësim të saktë dhe të krahasueshëm të ofertave, duke analizuar në mënyrë të qartë nëse produktet e propozuara përmbushin kërkesat minimale teknike apo specifikimet e kërkuara. Kjo shmang interpretimet subjektive dhe rrit transparencën në procesin e vlerësimit, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Gjithashtu, katalogët dhe skedat teknike shërbejnë si provë e origjinës dhe standardizimit të produkteve, duke treguar se ato janë pjesë e një linje të rregullt prodhimi dhe jo produkte të paidentifikuara apo të prodhuara pa kontroll cilësie. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të shmangur furnizimin me produkte që nuk përputhen me përshkrimet e dhëna në ofertë ose që nuk kanë karakteristikat e deklaruara.

Kjo kërkesë kontribuon gjithashtu në fazën e zbatimit të kontratës, pasi dokumentacioni teknik i paraqitur në ofertë shërben si referencë për verifikimin e mallrave në momentin e dorëzimit. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor ka një bazë të qartë për të kontrolluar nëse produktet e furnizuara janë në përputhje me ofertën e fituesit dhe me kërkesat kontraktore.

Nga pikëpamja e proporcionalitetit, kjo kërkesë nuk përbën barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë, pasi katalogët dhe skedat teknike janë dokumente standarde që çdo prodhues apo distributor serioz i mobiljeve i disponon në kuadër të aktivitetit të tij tregtar. Për më tepër, pranimi i fragmenteve të katalogut e bën kërkesën fleksibël dhe të arritshme për të gjithë operatorët.

Në përfundim, kërkesa për paraqitjen e katalogëve ose skedave teknike është një element thelbësor për të garantuar një proces vlerësimi objektiv, transparent dhe të bazuar në prova, duke siguruar që mobiljet e ofruara përmbushin plotësisht specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së prokurimit, mostër të produkteve si më poshtë:

- Bank dyshe e çmontueshme
- Bank teke e çmontueshme
- Dollap metalik me dyer
- Klasifikator metalik me tre sirtarë
- Karrige auditori

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: pranë stadiumit, Himarë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe pikën

6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë mostra të produkteve në datën dhe orën e hapjes së prokurimit ka një rëndësi të veçantë për vlerësimin objektiv dhe të qartë të ofertave për blerjen e mobiljeve. Paraqitja e mostrave për artikujt kryesorë – bankat dyshe dhe teke të çmontueshme, dollapët metalikë, klasifikatorët metalikë dhe karriget e auditorit – siguron që autoriteti kontraktor mund të kontrollojë cilësinë, qëndrueshmërinë, materialet dhe përputhshmërinë me specifikimet teknike të përshkruara në dokumentacionin e tenderit.

Mostrat e paraqitura fizikisht lejojnë një vlerësim të drejtpërdrejtë të dimensioneve, strukturës, përfundimeve sipërfaqësore, sigurisë dhe ergonomisë së produkteve, të cilat nuk mund të konfirmohen plotësisht vetëm me katalogë ose skeda teknike. Për shembull, për mobiljet shkollore, struktura mbajtëse e bankave ose dollapëve, lartësia e karrigeve dhe rezistenca e materialeve janë elementë kritikë për sigurinë dhe përdorimin e përditshëm, dhe kjo vetëm një provë fizike mund të verifikojë në mënyrë të besueshme.

Kërkesa gjithashtu përforcon transparencën dhe barazinë midis operatorëve ekonomikë, pasi të gjithë pjesëmarrësit duhet të paraqesin mostra në të njëjtën kohë dhe vend, duke eliminuar mundësitë për favorizim apo përfitime të paligjshme. Mostrat e paraqitura pranë Autoritetit Kontraktor, në vendin dhe kohën e përcaktuar, ofrojnë një bazë objektive për krahasimin e cilësisë së produkteve të ofruara nga operatorë të ndryshëm.

Nga pikëpamja e proporcionalitetit, kjo kërkesë është e arsyeshme dhe e standardizuar për prokurime ku cilësia fizike e produktit ka rëndësi të veçantë. Mostrat nuk kërkojnë volum të madh ose përgatitje të jashtëzakonshme për operatorët seriozë, pasi ato përfaqësojnë sasinë minimale që lejon vlerësimin teknik të produktit. Për më tepër, kjo procedurë redukton rrezikun që mallrat e dorëzuara të mos përputhen me ofertën fituese, duke garantuar cilësi dhe përputhshmëri me standardet e kërkuara.

Në përfundim, kërkesa për paraqitjen e mostrave fizike është një mjet thelbësor teknik për të verifikuar në mënyrë objektive dhe të besueshme cilësinë dhe përputhshmërinë e mobiljeve me specifikimet e tenderit, duke siguruar që operatori ekonomik ofron produkte që plotësojnë standardet e kërkuara dhe nevojat e autoritetit kontraktor.”.

III.3.4. Për pretendimin e mësipërm të ankimesit, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 362/13 prot, datë 14.04.2026 “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1067/1 prot, datë 15.04.2026, ku ka dërguar vendimin nr. 362/12 prot, datë 14.04.2026 “Vendim mbi

shqyrtimin e ankesës së OE “KLAME” SHPK” të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Klame” SHPK, nuk e ka pranuar këtë pretendim të ankimesit, duke argumentuar si në vijim: “Lidhur me pretendimin për kërkesën e paraqitjes së mostrave, vlerësoj se Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenin 40 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ka të drejtë të kërkojë mostra kur kjo është e nevojshme për vlerësimin e ofertës teknike dhe për të garantuar përputhshmërinë e mallrave me specifikimet e kërkuara. Në rastin konkret, kërkesa për mostra është vendosur për të mundësuar verifikimin e drejtpërdrejtë të cilësisë, qëndrueshmërisë dhe karakteristikave teknike të produkteve, duke qënë se objekt i prokurimit lidhet me mobilje, për të cilat vlerësimi fizik është thelbësor. Në këtë kuadër, çmoj se kërkesa për paraqitjen e mostrave është e justifikuar, e arsyeshme dhe në përputhje me natyrën e kontratës, pasi mundëson një vlerësim më të saktë dhe objektiv të ofertave teknike, si dhe kontribuon në garantimin e transparencës dhe tratimit të barabartë të operatorëve ekonomike. Për rrjedhojë, pretendimi për heqjen ose ndryshimin e kësaj kërkesë nuk qëndron dhe nuk mund të pranohet, duke vendosur që kërkesa për paraqitjen e mostrave të mbetet e pandryshuar, sipas përcaktimeve në dokumentet e tenderit.”.

III.3.5. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.3.6. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.7. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.8. Në nenin 40, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo

gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.3.10. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Komisioni konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriterë të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit. Nga shqyrtimi i kriterëve të kualifikimit, KPP vëren, se për disa nga artikujt objekti prokurimi, konkretisht si në vijim: “Bank dyshe e çmontueshme; Bank teke e çmontueshme; Dollap metalik me dyer; Klasifikator metalik me tre sirtarë dhe Karrige auditori.”, kërkohet dorëzimi i mostrave në ambientet e autoritetit kontraktor, ndërkohë që po për këto artikuj kërkohet që të paraqiten edhe katalogë ose skeda teknike, të cilat të përmbajnë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga operatori ekonomik ankimues, në ankesën e tij, gjykojmë, se referuar

objektit të prokurimit si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, gjykojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave për artikujt e sipërpërmendur është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit që kërkohet të prokurohet, si dhe është një kërkesë e dubluara, pasi në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin katalogët apo skedat teknike të produkteve që do të ofertoohen me qëllim që të verifikohet fakti nëse produktet e ofruara i plotësojnë ose jo specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimi të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Vlen të theksojmë, se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e kriterëve të kualifikimit autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, e cila kufizon pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi.

Akoma më tej, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar që në fazën e ofertimit përmbushja e specifikimeve teknike të produkteve të ofruara do të përmbushet nga ana e ofertuesve edhe me dorëzimin e katalogëve apo skedave teknike të produkteve të ofruara, si dhe për më tepër autoriteti kontraktor ka në dispozicion edhe momentin procedural të kontrollit të dytë pas lidhjes së kontratës të përputhshmërisë së produkteve të furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë.

Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues qëndron, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e tenderit objekt ankimi, duke hequr kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.9 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, pasi kjo kërkesë është një kërkesë e dubluar dhe për më tepër është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*KLAME*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e*

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetëmilion e katërqindënëntëdhjetekatërmijë e një), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetëmilion e katërqindënëntëdhjetekatërmijë e një), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
 3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

